

REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS			
17.01.2018			
Mj. U. r.	Numër	Shifra	Vendi
10	030	3394	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT



PROGRAMI DHE PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

Drenas, janar 2018

Në mbështetje të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale dhe në vështrim të nenit 76, pika 1, të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe nenit 86, Drejtori i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport paraqet këtë:

PROGRAM DHE PLAN TË PUNËS PËR VITIN 2018

DETYRAT E DREJTORISË PËR KULTURË, RINI, SPORT, BIBLIOTEKA, ARKIV.

- Koordinon dhe organizon punët në zhvillimin e kulturës;
- Udhëheqë aktivitetin e SHKA-ve amatore;
- Kryen punët në lidhje me bibliotekat e komunës;
- Përpunon, sistemon dhe formon fondin e lëndëve arkivore;
- Mbrojtjen e vlerave kulturore;
- Mbikqyrë stafin e klubeve dhe ekipeve sportive ;
- Organizon punën e klubeve dhe aktiviteteve sportive nëpër shkolla;
- Menaxhon objektet sportive;
- Udhëheqë aktivitetet me rinin;
- Organizon dhe udhëheqë trajnimin me të rinjtë.

PROGRAMI I DHE PLANI I DREJTORIT TË DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE SPORT


Për të realizuar detyrat dhe obligimet e përcaktuara me Statutin e komunës dhe dispozitat ligjore, gjatë vitit kalendarik 2018, drejtori i këtij institucioni do të përqendrohet në parashtrimin e objektivave për DKRS-në;

- Do të përcillen mbledhjet e Bordit;
- Do të vejmë bashkëpunim me Drejtori-Ministri përkatëse;
- Do të prezentohen projekte ideore në organet përkatëse;
- Bashkëpunimi do të jetë me struktura e institucione tjera;
- Gjatë këtij viti do të vazhdojmë me aktivitetin e koordinimit dhe organizimit të punëve në zhvillimin dhe avancimin e kulturës në trevën e Drenasit;
- Së bashku më përgjegjësit e sektoreve do të bashkëveprojmë që të intensifikohet aktiviteti në SHKA-të amatore nëpër vendbanimet dhe lokalitetet e komunës;
- Synim tjetër i Drejtorisë do të jetë angazhimi në punët e pasurimit të fondit të bibliotekave të komunës
- Një segment tjetër i rëndësishëm i aktivitetit të Drejtorit do të jetë edhe ndihma e përqëndruar në përpunimin, sistemimin dhe formimin e fondeve të lëndëve arkivore;
- Preokupim i Drejtorit gjatë këtij viti do të jetë në mbrojtjen e vlerave kulturore dhe trashëgimisë kulturore në komunën tonë;
- Drejtori i kësaj drejtorie do të angazhohet edhe në mbikqyrjen e stafit të klubeve dhe ekipeve sportive që garojnë në rangje të ndryshme të Kosovës
- Angazhim i drejtorit ,në qendër të vëmendjes do të jetë edhe menaxhimi i objekteve sportive;

- Bashkarisht me përgjegjësit e sektoreve do të ndihmojë edhe udhëheqjen e aktiviteteteve me rininë;
- Drejtori do të kordinon dhe ndihmon edhe organizimin dhe udhëheqjen e trajnimeve me të rinjtë.

Organizimi i Brendshëm

Për realizimin sa më të sukseshëm të të gjitha detyrave dhe obligimeve që burojnë nga sfera e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e objektivave tjera që përfshin ky rrafsh, për përmbushjen e synimeve për t'i plotësuar kërkesat e auditorit që konsumon vlerat kulturore e për të kryer shërbimet e përgjithshme DKRS, angazhon një staf profesional, në mesin e të cilëve janë një strukturë prej 1 punëtor me master, 3 me fakultet, 1 me Shkollim të lartë profesional, 4 me Shkollë të mesme. Pra, për përmbushjen e detyrave, që përfshinë fusha e Kulturës, Rinisë, Sportit, Bibliotekave, Arkivi janë të angazhuar 10 punëtorë. Vështuar sipas sektoreve struktura organizative dhe profesionale gjatë këtij viti do të ketë, këtë pamje. Në vazhdim paraqesim skemën organizative.



Sektori i Kulturës

Objektivat kryesore të Sektorit të Kulturës janë të përqëndruara në realizimin e këtyre punëve dhe detyrave:

- Përgatitja e raportit të punës për vitin 2017 dhe programit për vitin 2018.
- Analiza e punës dhe aktiviteteve me SHKA-të e bashkësive lokale të komunës së Drenasit;
- Konsultime me arsimtarët e muzikës të shkollave fillore rreth festivalit të grupeve artistike të shkollave fillore rreth kriterëve për vitin 2018.
- Përgatitja e propozimeve për festivalin e GKA dhe shpërndarja e tyre në shkolla ku zhvillohet aktiviteti.
- Program artistik për ditë të pavaresisë;
- Përgatitjet për sofrën poetike Ymer Elshani, 2018
- Sofra poetike Ymer Elshani 2018.
- Program artistik për 14 qershorin ditën e çlirimit të Drenasit.
- Program artistik për mërgimtarët.
- Koordinimi rreth riaktivizimit të mundshëm të shoqërive amatore në zona rurale
- Angazhimi i dy shfaqjeve nga teatri;
- Përkrahja e projekteve për botime, furnizim me literaturë etj, rreth shtatë projekte.
- Përgatitjet për Festivalin, Ditët e humorit Drenasi 2018.
- Manifestimi Ditët e humorit Drenasi 2018.

Sektori i Rinisë

Aktiviteti rinor në komunën tonë do të përfshijë këto segmente të punës:

- Përpilimi i planit të aktiviteteve rinore për vitin 2018.
- Seminar mbi të drejtat e të rinjëve „Dhuna në familje”.
- Përkrahja e projekteve rinore deri katër projekte që kanë në qendër të aktivitetit rininë.
- Tribunë për vetëdijësimin dhe edukimin e të rinjëve dhe mundësin e kyqjes në jetën shoqërore civile;
- Aktivitete sportive në bashkëpunim me Sektorin e Sportit;
- Tribunë dhe ligjërata për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit si dhe shëndetit nëpër zona rurale;
- Revista rinore;
- Aktivitete me Handikosin dhe shoqatën e shurdh memecëve;
- Mbrëmje rinore për nder të ditës së çlirimit të Drenasit;
- Mbajtja e muajit rinor;
- Ekspozitë për festat e Nëntorit;
- Fushatë për parandalimin e AIDS-it, ligjërata, debate dhe tribuna me të rinjt;
- Analizë e punës njëvjeqare.

Sektori i Sportit

Programi për zhvillimin e sportit dhe organizimin e tij në këtë komunë do të përmbajë këto objektiva:

- Përgatitja e raportit të punës për vitin 2017 dhe programit të punës për vitin 2018;
- Trajnim për refer, trajner në futboll, hendboll, boks etj;
- Këshillime profesionale me klube sportive dhe sportist;
- Takim pune me klubet sportive të regjistruara sipas Ligjit të Sportit;
- Turnire për nderë të festave kombëtare dhe shtetërore.
- Pagesa e kootizimit dhe licencimit të klubeve për sezonën pranverore-vjeshtore;
- Ndihmë shoqatave sportive;
- Kroset komunale- pranveror vjeshtor;
- Garat e pionerëve dhe të rinisë shkollore;
- Turnir memorial-tradicional në futboll;
- Bashkëpunim dhe përcjellje të ushtrimeve dhe ndeshjeve sportive të klubeve tona;
- Analizë e punës një vjeqare e Sektorit të Sportit;
- Përkrahja financiare e 12 projekteve të klubeve dhe shoqatave sportive
- Manifestimi për zgjedhjen e sportistit të vitit 2018.

ARKIVI

Arkivi historik në Drenas është i tipit të përgjithshëm, lëndën që posedon dhe e ka në ruajtje të përhershme, kryesisht përmban dokumentacion me karakter ekonomik, social, politik, pronësor-juridik dhe sistemor. Njëherit posedon edhe me të dhëna historike të vendbanimeve në teritorin e komunës së Drenasit dhe regjionit të Drenicës.

Do ti kushtohet kujdes i veçant (respektimi i ligjit) lëndës arkivore jashtë arkivit (nëpër organizata në teren).

Duhet të sigurohen raftat për kompletimin e fondeve që ende nuk janë të vendosura në rafta.

Do të bëhen vizita në të gjitha arkivat e organizatave të ndryshme për tu njohur më për se afërmi me gjendjen e lëndës.

Do të tubohen dhe të merren memoaret – kujtimet e individëve të caktuar për ngjarje të caktuara si çështje sistemore për arsim, shëndetësi, ekonomi dhe lëmit shoqërore gjatë periodës së sundimit të dhunshëm, njëherit në mënyrë të veçant do të merren kujtimet nga personat e vjetër për ngjarjet e caktuara.

Depoja do të mbikqyret , kujdeset për lëndën në depo vurjen e kutijave në rafta të caktuara, ajrosja, kontrollimi i temperaturës si dhe evidentimi i fondeve. Gjatë kësaj periudhe qytetarëve nga shërbimi i mbrendëshëm dhe i depos do të ju ofrohen dokumente të ndryshme si deshmi dhe qertifikata. Plani detal mujor javor dhe ditor mbetet në Arkivin Historik në Drenas.

Biblioteka

Gjatë vitit 2018 do të punohet kryesisht në:

- Sigurimin e fondit të librave;
- Klasifikimin e librave sipas natyrës dhe veprimtarive.
- Përpunimin e librit.
- Klasifikimin e librit.
- Dhënia e signaturave librit.
- Përpunimin e Katalogut të bibliotekës.
- Renditjen e librave në raftet .
- Biblioteka do të shtoj numrin e lexuesve.
- Dhënjën e librit në lexim.
- Pranimin e librave nga lexuesit.
- Evidentimin e lexuesve me kartona të lexuesve.
- Do të kryhen edhe punët tjera si ato administrative dhe pastrimi i librit dhe lokalit në përgjithësi.

MASAT PROPOZUESE TË DREJTORATIT PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Krahasuar me planin e punës, obligimet ligjore dhe burimet buxhetore, vlerësojmë se pjesa qendrore e objektivave për vitin 2017 në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë përmbushur por për të pasur një jetë më të begatshme kulturore dhe sportive në Drenas mendojmë se imperativisht janë këto objektiva, të cilat nuk mund të përmbushen veq me buxhetin e paraparë për vitin 2017.

- Ndërtimi i Stadionit faza e dytë
- Ndërtimi i Parkut Vasilevë
- Ndërtimi i një Shtëpie të Kulturës
- Ndërtimi i një Qendre Rinore
- Sigurimi i një objekti për zhvillimin e aktivitetit të SHKA Ymer Alushani, Bushat

Domosdoshmëri e funksionimit më të mirë të DKRS-së dhe krijimit të hapsirës dhe ambientit më të mirë për të rinj, për këtë qëllim është e domosdoshme mbështetja e të gjitha organeve të Komunës së Drenasit që të këto projekte të sendertohen gjatë vitit që kemi hyrë sipas planifikimit.

PLANI FINANCIAR SIPAS MUAJVE TË VITIT

SEKTORI I KULTURËS

JANAR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Përgaditja e raportit të punës për vitin 2017	/	/
2.	Hartimi i planit të punës për vitin 2018	/	/
3.	Konsult me arsimtarët e edukatës muzikore për Festivalin e GKA-ve	/	/
4.	Bisedë me grupe amatore për aktivizimin e SHKA-ve.	/	/

SHKURT

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Program artistik per ditë të pavarësisë	/	500€
2.	Pjesëmarrja e SHKA-ve në festivale dhe manifestime	/	/

MARS

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Ndihmë financiare për SHKA	/	2.500
2.	Pregaditjet për mbajtjen e sofres poetike		

Gjithsej..... /.....3.000€

PRILL

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Ndihmë për grupet amatore, kulturore	/	1.500€
2.	Sofra poetike,,Ymer Elshani 2018"	300€	1.000€
3.	Përgaditja e një premiere nga teatri	/	1.000€
4.	Koordinimi me SHKA-të lidhur me aktivitetet	/	/

MAJ

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Pjesëmarrja e SHKA-së në festivale të ndryshme	/	/
2.	Përgaditjet për kremtimin e ditës së çlirimit të Drenasit	/	/

QERSHOR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Program per ditën e Çlirimit të Drenasit	300€	1.500€
2.	Shfaqja e një premiere nga teatri	/	/
4.	Pjesëmarrja e teatrit në festivalin e teatrove-komedive në Mitrovicë	/	/

Gjithsej.....600€.....5.000 €

KORRIK

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Koncert për bashkatdhetar	/	1.500
2.	RFBSH Drenasi 2018	/	/

GUSHT

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1	Analiza e punës gjashtëmujore	/	/

SHTATOR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Formimi i grupit seleksionues per humoriad 2018	/	/
2.	Vazhdimi i punës me SHKA të bashkive lokale	/	/
3.	Repriza e premieres nga teatri	/	/

Gjithsej.....0€1.500.....

TETOR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Mbajtja e ditëve të humorit 2018	300€	500€
2.	Angazhimi i një shfaqje nga teatri kombëtar	/	/
3.	Java e filmit kosovar	/	/

NËNTOR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencione
1.	Koncert per nder të festave të Nëntorit	/	300€
2.	Pjesëmarrja e rapsodëve në Skenderaj	/	/

DHJETOR

Nr.	Aktiviteti	Mall.sher.	subvencion
1.	Program për vit të ri	/	1.000
2.	Raporti i punës për vitin 2018	/	/
3.	Përgaditja e programit të punës për vitin 2019	/	/

Gjithsej.....300€.....1.800€

TOTAL.....900€ (mallra dhe shërbime)

.....11.300€ (Subvencione)

SEKTORI I SPORTIT

JANAR

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Përgatitja e raportit të punës për vitin 2017	/	/
2.	Hartimi i plan-programit të punës për vitin 2018	/	/

SHKURT

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Ftesa për aplikim	/	/
2.	Turnir për nder të 28 shkurtit festes komunale	/	/

3.MARS:

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	- Përcjellja dhe këshillime profesionale me klube sportive dhe me të gjithë sportistët-trajnime	/	/
2.	Ndihmë financiare KH„Drenica”, KF„Feronikeli” dhe klubet tjera (s.pranveror)	/	23.300€
3.	Ndihmë shoqatave sportive dhe individëve	/	/

Gjithsej:.....23.300€

PRILL

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Krosi komunal pranveror	600 €	/
2.	Ndihmë materiale shkollave (futboll,hendboll etj.)	/	/

MAJ

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb..	Subvencion
1.	Garat e pionerëve dhe rinisë shkollore	1.200 €	500€

2.	Turnir memorial-tradicional në futboll të vogël	/	1.500
----	---	---	-------

6.QERSHOR:

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Turnire sportive për nder të ditës së çlirimit të Drenasit .	/	/
3.	Ndihmë klubeve sportive	/	10.000€

Gjithsej.....1.800€.....12.000€

KORRIK

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Kampet verore për pioner(futboll dhe hendboll etj.)	/	/

GUSHT

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Aktivitete sportive për bashkatdhetar	/	/

SHTATOR

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Turnir memorial-tradicional në hendboll	/	/

Gjithsej..... /

TETOR

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Krosi komunal vjeshtor	600 €	/

NËNTOR

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Turnire të hapura sportive per festat e nëntorit	/	/

DHJETOR

Nr.	Aktiviteti	Mall&sherb.	Subvencion
1.	Analizë e punës njëvjeqare e sektorit të sportit	/	/
2.	Manifestim për zgjedhjen e sportistit të vitit 2016	/	1.000

Gjithsej.....600€.....1.000€....

TOTALI:.....2.400 € (Mallra dhe sherbime)
36.300 € (Subvencione)

SEKTORI I RINISË

JANAR

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti- Subvencione
1.	Përgaditja e raportit vitin 2017 dhe përpilimi i planit të punës për vitin 2018	/

SHKURT

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Takime pune me OJQ-të, grupet rinore, informim rreth aktiviteteve dhe shpallja e ftesës për aplikim.	/

MARS

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Projekti „Edukimi dhe vetëdijësimi i rinisë, dhuna në familje dhe trafikimi i qenieve njerëzore”- debate dhe tribuna	/
2.	Aktivitete rinore në bashkpunim me sektorin e sportit	/

Gjithsej:..... /

PRILL

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Pastrimi i qytetit	/
2.	Revista	600€

MAJ

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Tribunë dhe ligjërata për „Ruajtjen e ambientit dhe shëndetit” nëpër zona rurale	/

QERSHOR

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Mbrëmje rinore argëtuese për nder ditës së çlirimit	300€
2.	Ndihmë OJQ-ve -Handikosit	500€

Gjithsej.....1.400 €

KORRIK

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.		/

GUSHT

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1	Aktivitete të ndryshme me hendikosin dhe shoqatën e shurdhëmecëve	/
2..	Përgaditja për muajin e rinisë	/

SHTATOR

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
2.	Muaji i rinisë	1.000 €

Gjithsej:.....1.000 €

TETOR

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Trajnim i të rinjve „I riu për të riun”- parandalimi i dukurive negative: prostitucioni, duhani, narkomania, alkoolizmi	/

NËNTOR:

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Ekspozitë për festat e nëntorit	/

DHJETOR:

Nr.	Aktiviteti	Bugjeti-subvencione
1.	Fushatë për parandalim të AIDS-it-ligjërata dhe debate	/
2.	Analiza një vjeqare e punës	/

Gjithsej:...../...

TOTALI:..... 2.400€ (Subvencione)

TOTALI: KULTURA-	subvencione: 11.300,00.....	Mallra dhe shërbime: 900,00
SPORTI-	subvencione: 36.300,00.....	Mallra dhe shërbime: 2.400,00
RINIA-	subvencione: 2.400,00.....	Mallra dhe shërbime: /
Gjithsej:	subvencione 50.000,00	Mallra dhe shërbime: 3.300,00

Drenas, 17.01.2018

Drejtori:

